

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pas përplasjeve me Hegseth, jep dorëheqjen Sekretari i Ushtrisë amerikane – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/pas-perplasjeve-me-hegseth-jep-doreheqjen-sekretari-i-ushtrise-amerikane/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHÀ


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 23:33:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	1 shtator 2026, 11:38:22 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	eb092ab1185fe3d494b43efc1a65b97ee16b7aa200fcfd52a378977dc51630e
TEKSTI	eb9c0abd036689765cb151076bfb8f04e6181d86fd7f8ea5b7860f72d654c8b1
PAMJA	a587145cf30cc4715b6d0980ea1b4508bc9707fc0893efc4bec5cd2f3355a6cc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	07a4762440c4588c1c620848bd5834d46c81cd14bde069571f7e9b1e52006493
E MËPARSHMJA	2810590185d3fba07509656a0332008bf07f775cc0429225644df7d5904d6ffa
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/07a4762440c4588c1c620848bd5834d46c81cd14bde069571f7e9b1e52006493>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Sekretari i Ushtrisë amerikane, Dan Driscoll, ka paraqitur dorëheqjen në Shtëpinë e Bardhë të hënën, pas disa muajsh përplasjesh me sekretarin e Mbrojtjes, Pete Hegseth.

Sipas personave të njohur me situatën, Driscoll ka zhvilluar një bisedë me presidentin Donald Trump të hënën, ku ka shprehur shqetësimet e tij për drejtimin që po merr Ushtria amerikane.

Përplasjet mes Driscoll dhe Hegseth kanë të bëjnë kryesisht me modernizimin e Ushtrisë dhe largimin nga detyra të disa prej drejtuesve të lartë ushtarakë. Mes tyre ishte edhe ish-shëfi i Shtabit të Ushtrisë, gjenerali Randy George, një oficer i vlerësuar dhe me karrierë të gjatë ushtarake.

Driscoll, veteran i luftës në Irak dhe aleat i afërt i nënpresidentit JD Vance, u kishte thënë prej muajsh njerëzve të afërt se planifikonte të largohej nga Pentagoni rreth zgjedhjeve afatmesme amerikane.

Megjithatë, dorëheqja e tij vjen në një moment të vështirë për administratën amerikane. Pentagoni po përballlet me një konflikt të zgjatur në Lindjen e Mesme dhe me mungesë të drejtuesve të lartë të konfirmuar nga Senati.

Nuk është ende e qartë nëse presidenti Trump e ka pranuar zyrtarisht dorëheqjen e Driscoll dhe kush do ta zëvendësojë atë si sekretar në detyrë të Ushtrisë.

Edhe Dave Fitzgerald, zëvendëssekretar i Ushtrisë, pritet të largohet nga Pentagoni gjatë kësaj jave. Fitzgerald dhe Driscoll kanë qenë ndër zërat

5 Begaj uron nisjen e vitit të ri shkollor:
Besoni te vetja dhe tek ëndrrat,...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

kryesorë që kanë mbështetur përfshirjen e kompanive të vogla teknologjike në Ushtrinë amerikane, me synimin për ta bërë atë më fleksibël dhe më inovative.

Ndërkohë, Hegseth ka larguar nga detyra dhjetëra zyrtarë dhe drejtues ushtarakë që kanë mbështetur iniciativa të ngjashme.

Mes tyre ishte gjenerali James Mingus, ish-zëvendës shefi i Ushtrisë, si dhe gjenerali Christopher Donahue, i cili ka komanduar forcat amerikane në Evropë dhe Afrikë dhe ka luajtur rol të rëndësishëm në mbështetjen e Ukrainës dhe planifikimin ushtarak ndaj Rusisë.

Pas largimit të Mingus dhe George, të dyja pozicionet u morën nga gjenerali Christopher LaNeve, i cili u përzgjedh nga Hegseth në një lëvizje të papritur dhe u ngrit në gradën e gjeneralit me katër yje.

Tani, Ushtria amerikane do të drejtohet nga LaNeve si shef në detyrë i Shtabit dhe nga një zyrtar civil në detyrë, ndërsa përballet me sfida të rëndësishme në Lindjen e Mesme dhe Evropë.

#DanDriscoll

#Hegseth



Xhuljana Zhuleku

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



BOTA

Trump i kërkon Zelenskyt të...

Xhuljana Zhuleku 37 minuta më parë



BOTA

Tragjedi! Përmbysset anija me pasagjerë,...

Xhuljana Zhuleku Dje 23:17



BOTA

Zjarr masiv në Kroaci, evakohen 230...

Xhuljana Zhuleku Dje 19:36



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑